



Zhvillimi dhe institucionalizimi i strategjisë afatgjatë për mirëmbajtjen e ndërhyrjeve

■



Projekti: "Ndërtimi për rikuperimin e Lagunës Kune - Vain nëpërmjet përshtatjes së bazuar në ekosistem (EbA)"

Përmbajtja

Permbledhje ekzekutive.....	5
HYRJE:.....	6
1. Qëllimi dhe objektivat e strategjisë afatgjatë të ndërhyrjeve	7
2. Ripyllzimi	8
2.1 Përse është i nevojshëm ripyllzimi:	8
2.2 Të dhëna për projektin e ripyllzimit.	8
2.3 Ripyllzimi si qasje EbA	11
2.4 Protokollin e mirëmbajtjes për ripyllzimet në Kune Vain.	11
2.5 Ripyllzimi - mirëmbajtja.....	11
2.4 Mirëmbajtja afatgjatë e ripyllzimeve.....	12
3. Rehabilitimi i Dunave.....	14
3.1 Protokollet teknike për rehabilitimin e dunave - rekomandimet dhe përfitimet kryesore.....	14
3.2 Përse është e nevojshme ndërhyrja:.....	14
3.3 Përshkrimi i shkurtër i ndërhyrjes.	16
3.3.1 Speciet e zgjedhura për mbjellje	16
3.3.2 Vend-ndodhja dhe skema e mbjelljes	16
3.3.3. Shërbimet pas mbjelljes	17
3.3 Mirëmbajtja afatgjatë për rehabilitimin e dunave.....	17
4. Hapja e Kanalit të Baticës (kanali i ujëkëmbimit midis detit Adriatik dhe lagunës së Cekës, Vain).	19
4.1 Pse është e nevojshme ndërhyrja.....	19
4.2 Objektivi dhe zgjedhja e vendit të ndërhyrjes:.....	19
4.3 Të dhëna teknike	20
4.4 Kanali i baticës si qasje EbA.....	22
4.5 Protokollin e mirëmbajtjes për kanalin e baticës	22
4.6 Mirëmbajtja afatgjatë e kanalit të baticës, sistemi lagunor Kune Vain.	22
4.6. 1. Qëllimi dhe objektivat:	22
4.6.2 Justifikimi/ Përshkrimi.....	23
4.6.3 Masat e mirëmbajtjes për t'u zbatuar	23
4.7 Plani për vazhdimin e mirëmbajtjes pasi projekti ka përfunduar.	24
5. Plani i komunikimit për të përhapur rezultatet e aktiviteteve të mirëmbajtjes	25

Permbajtja e tabelave

Tabela 1. Punimet e mirëmbajtjes së planifikuar për ripyllzimet.....	11
Tabela 2. Përmbledhje e shpenzimeve për punimet e mirëmbajtjes (për dy vjet të kultivimit).	12
Tabela 3. Aktivitetet e mirëmbajtjes, plani strategjik.....	13
Tabela 4. Rehabilitimi i dunave, skema e mbjelljes	16
Tabela 5. Kostot totale të rehabilitimit të dunave.....	17
Tabela 6. Aktivitetet e mirëmbajtjes, plani strategjik.....	18

Figurat

Figura 1 Te dhëna për ripyllzimet pergjatë rrugeve.	9
Figura 2 Vend-ndodhja e ripyllzimeve (SLKV).....	10
Figura 3. Vend-ndodhja e rehabilitimit të dunave (SLKV).....	15
Figura 4. Vend-ndodhja e ndertimit të kanalit të batices (SLKV).....	20
Figura 5. Seksioni i kanalit (projekti i hartuar nga STAR ENGINEERING JV NORD-COMAT).....	21
Figura 6. Pamje e kanalit nga imazhi satelitor dhe projekti i hartuar nga STAR ENGINEERING JV NORD-COMAT.....	21

Shkurtime

AAP	Agjensia e Administrimit te Pyjeve, Bashkia Lezhë
NjA	Njesia Administrative e Bashkisë së Lezhës
QVNM	Qendra e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis
KT	Keshilltar Teknik
DB	Drejtoria e Bujqesisë, Bashkia e Lezhës
DBQL	Drejtoria e Bujqesisë, Qarku Lezhë
DBK	Drejtoria e Bordit të Kullimit
DATKS	Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kultures dhe Sporteve, Bashkia e Lezhës
DIPZh	Drejtoria e Integrimit dhe Programeve te Zhvillimit, Bashkia e Lezhës
DZhRI	Departamenti i Zhvillimit Rajonal dhe Integrimit, Këshilli i Qarkut, Lezhë.
KTL	Keshilltar Teknik Lokal
EbA	Parshtatja e Bazuar ne Ekosistem
SMK	Strategjia e Monitorimit dhe Kerkimit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
RTRD	Raportet Teknike per Rehabilitimin e Dunes
KEL	Klubi Ekologjik, Lezhë
SLKV	Sistemi Lagunor Kune Vain
KMZML	Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, Lezhë
AZhRL	Agjensia e Zhvillimit Rajonal e Lezhës
BL	Bashkia e Lezhës
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKZM	Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AdZM	Administrata e Zonave të Mbrojtura
AKB-DL	Agjensia Kombëtare e Bregdetit, Dega Lezhë
PM	Projekt Menaxher
KDP	Komiteti Drejtues i Projektit
DRML	Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Lezhë
QRM	Qendra Rajonale e Mjedisit

Përmbledhje ekzekutive

Zona e Mbrojtur Kune Vain Tale, është një zonë e mbrojtur shqiptare e cila ndodhet ne Bregdetin e Adriatikut.Ndërhyrjet e paplanifikuara njerëzore dhe efektet e ndryshimit të klimës, kanë përkeqësuar seriozisht vlerat e zonës së mbrojtur.Kjo është arsyeja pse, Projekti i Fondit të Veçantë për Ndryshimin e Klimës (SCCF) është mobilizuar për të rritur kapacitetin e qeverisë dhe komuniteteve lokale që jetojnë pranë SLKV për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike duke përdorur një paketë të integruar të ndërhyrjeve të adaptimit, përfshirë EbA, e cila konsiderohet më e efektshme e afatgjatë përkundrejt masave të vështira të infrastrukturës.

Objektivi i Projektit:

Të rrisi aftësinë e qeverisë dhe tëkomuniteteve lokale që jetojnë pranë sistemit lagunor Kune-Vain për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike duke përdorur një pakete të integruar të ndërhyrjeve të përshtatjes përfshirë EbA-n.

Projekti i rikuperimit të Kune Vainit, konsiderohet si një projekt pilot që do të përdoret si bazë për projektin e ardhshëm EbA. Sipas komponentit të dytë nga të tre komponentët e projektit të rikuperimit të Kune Vainit, "Demonstrimi i ndërhyrjeve të përshtatjes brendaSLKV, janë duke u zbatuar:

- a) Hapja e kanalit të baticës midis detit Adriatik dhe lagunës së Vainit (Ceka). Kjonnderhyrje do të përmirësojë cilësinë e ujit në lagunë, do të rrisë popullatat e peshqeve dhe biodiversitetin në tëresi dhe vlera ekonomike, duke ndihmuar kështu në rritjen e nivelit tëstandardit të jetesës së komunitetit që jeton nëafërsi dhe që merret me peshkim dhe turizëm.
- b) Ripyllëzimi i 7 ha pyll i degraduar, i cili në të ardhmen do të përmirësojë biodiversitetin dhe restauroje habitatin.
- c) Stabilizimi i dunës (kontrolli i erozionit) duke mbjellë 2ha me barin e plazheve dhe shkurre endemike. Restaurimi i një pjese të dunave të degraduara dhe të dëmtuara në zonën bregdetare të Kune.

Të gjitha ndërhyrjet trajtohen si zëra ekologjikë dhe në përputhje të plotë me kërkesat e planit të menaxhimit të KVT, zonimin e zonës së mbrojtur, çështjet kryesore që përballet, dhe promovimin e ndërhyrjeve EbA si veprime më efektive për të replikuar efektet e Ndryshimit të Klimës.

HYRJE:

Projekti "Ndërtimi i rikuperimit të Lagunës Kune-Vaini (KVL) përmes përshtatjessë bazuar në ekosistem (EbA)" është përgatitur dhe po zhvillohet duke marrë parasysh kërkesat mjedisore si një zonë e mbrojtur natyrore, në veçanti në përputhje me protokollet EBA, të plotësojesa më shumë që të jetë e mundur kërkesat për turizëm dhe peshkim ose aktivitete të tjera, dhe në përgjithësi të shmange konfliktet me komunitetin dhe të rrisi aq sa të jetë e mundur interesin e tyre për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

"Zhvillimi dhe institucionalizimi i një strategjie afatgjatë për mirëmbajtjen e ndërhyrjeve" për projektin "Ndërtimi i rezistencës së Lagunës Kune-Vaini (KVL) përmes përshtatjes të bazuar në ekosistem (EbA)", do të jetë një rezultat shumë i rëndësishëm për punimet e ardhshme për të siguruar qëndrueshmërinë dhe suksesin e ndërhyrjeve të projektit për një periudhë afatgjatë.

Theksojmë se "Zhvillimi dhe institucionalizimi i një strategjie afatgjatë për mirëmbajtjen e ndërhyrjeve" (SAM) është në përputhje me planin e menaxhimit për zonën e mbrojtur Kune-Vain dhe veçanërisht me "Strategjinë e monitorimit dhe kërkimit" (SMK) të përgatitur nënprojektin, "Ndërtimi i rikuperimit të sistemit lagunor Kune-Vaini (SLKV) përmes përshtatjes të bazuar në ekosistem (EbA)", duke pasur gjithmonë parasysh kapacitetet ekzistuese njerëzore dhe financiare të stafit të AdZM, mundësitë për bashkëpunim me institucionete tjera të lidhura drejtpërdrejt ose indirekt me administrimin e integruar të zonës bregdetare.

Hartimi i strategjisë afatgjatë mbështetet dhe zhvillohet në harmoni me komponentët themelorë të projektit dhe në mënyrë më të veçantë me:

- Të gjitha raportet teknike për ndërhyrjet në terren për këtë projekt;
- Rezultatet e deritanishme në drejtim të realizimit të ndërhyrjeve dhe të shërbimeve të mirëmbajtjes aktuale dhe ato të planifikuara për afat të shkurtër;
- Detyrimet ligjore dhe institucionale të institucioneve dhe subjekteve për menaxhimin afatgjatë të rezultateve të ndërhyrjes në përputhje me qëllimin e ndërhyrjeve;
- Të dhënat teknike që lidhen me performancën e shërbimeve të mirëmbajtjes në ndërhyrje të ngjashme;
- Konsultimet e kryera për këtë qëllim me stafin e AdZM, Kompaninë AlbGgarden, anëtarët e KMZM.

1. Qëllimi dhe objektivat e strategjisë afatgjatë të ndërhyrjeve

Objektivi i përgjithshëm i "Zhvillimit dhe institucionalizimit të një strategjie afatgjatë për mirëmbajtjen e ndërhyrjeve" është identifikimi i të gjitha shërbimeve të mirëmbajtjes që do të realizohen në një afat të gjatë për çdo ndërhyrje të kryer, pas përfundimit të projektit, në përputhje me protokollin EbA.

- Mobilizimi i të gjitha kapaciteteve financiare dhe njerëzore, teknike dhe institucionale për t'iu përgjigjur performancës së shërbimeve të mirëmbajtjes, për të siguruar suksesin e ndërhyrjeve në përputhje me protokollin EbA.
- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i rezultateve të ndërhyrjeve të realizuara nga projekti do të marrin parasysh të gjithë dinamizmin e ngjarjeve ekstreme klimatike, siç është rritja e shpeshtësisë së stuhive të fuqishme detare dhe ndikimit në bregdet, erërat e fuqishme, përmbytjet nga reshjet e mëdha, periudha kohore, futja e ujit me kripë në zonë etj.
- Po ashtu, mirëmbajtja e objekteve si rezultat i ndërhyrjeve do të zhvillohet në përputhje me rezultatet sipas strategjisë afatgjatë të kërkimit dhe monitorimit të hartuar për periudhën pas përfundimit të projektit.

Strategjia e mirëmbajtjes së ndërhyrjeve EbA në Kune-Vain, duhet të përqendrohet në çështjet që lidhen me ndikimet e ndryshimit të klimës në objektin e ndërhyrjes duke sjellë në këtë mënyrë një vlerë të shtuar për programin e mirëmbajtjes.

2. Ripyllëzimi

2.1 Përse është i nevojshëm ripyllëzimi

Siç dihet, burimet pyjore paraqesin një faktor të rëndësishëm natyror në përballimin e ndryshimit të klimës. Përveç përfitimeve ekonomike që përdorimi i tyre mbart, pyjet kanë vlerë të madhe në mbrojtjen e tokës, parandalimin e përmytjeve dhe cilësinë e ujit. Gjatë viteve të fundit, zona e mbulimit të pyjeve në SLKV është zvogëluar ndjeshëm, me degradim masiv kryesisht në speciet e pishave mesdhetare. Këto bashkësi pyjore gjenden veçanërisht në Kune dhe Vain afër zonës bregdetare. Kjo situatë ka ndikuar jo vetëm në uljen e biodiversitetit në Kune Vain dhe kërcënimin e ekuilibrit natyror për folezimin e shpendëve dhe mbarështimin e gjitarëve, por ka sjellë edhe ndryshime në mikro-klimë veçanërisht në regjimin e erës. Sipas vlerësimeve, rritja e nivelit të detit, në skenarin më të mirë (projekti DMRD) do të ketë një ndikim të rëndësishëm në zvogëlimin e sipërfaqes së pyjeve në zonën e Kune Vainit. Problemet kryesore të pyjeve në Kune Vain janë mjaft të ngjashme me ato në nivel lokal dhe kombëtar. Për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të pyjeve dhe efektet e mundshme në habitatet, është realizuar ripyllëzimi i katër parcelave në zonën Kune Vain. Kjo masë duhet të parandalojë në kohë efektet e parashikuara të ndryshimit të klimës. Ndër zonat e degraduara që do të konsiderohen si pilot dhe me përparësi më të lartë, janë parcelat: 21a, "Stomi i Nikoll Lucës", 27a "Ish Fazaneria", 15 C "Rera e detit" në zonën e Vaini dhe 13 b, në Zona e Kunes.

Objektivi i ndërhyrjes: Është instalimi i bimësisë pyjore përmes ripyllëzimit të parcelave të caktuara brenda zonës Kune -Vain. Kjo masë ka për qëllim të ruajë vlerat dhe shërbimet ekzistuese, të cilat komuniteti dhe shoqëria lokale përfitojnë nga kjo zonë, të promovojë vetëdijen dhe të ndryshojë qëndrimin e komunitetit lokal ndaj fenomenit të ndryshimeve klimatike.

2.2 Të dhëna për projektin e ripyllëzimit.

(Projekti i ripyllëzimit është hartuar nga NCETSD & Diava Consulting).

Parcelanr.13.b, ndodhet në anën veriore të bregdetit të Kunes.

- Sipërfaqja e mbjelljes 3.1 ha;
- Densiteti i mbjelljes 2x2m;
- Formula e mbjelljes 0.5Pisha e eger (P.halepensis) + 0.5 Pishë(P.pinea).
- Numri i filizave:Pishë e egër (P.halepensis) 3875; Pishë (P.pinea) 3875;
- Numri i filizave Total: 7750.

Parcela nr. 21a. ndodhet në lindje të zonës së Vainit, në një distancë 1.5 km nga fshati Barbulloje.

- Emri lokal: “Stomi i Nikoll Lucës“;
- Sipërfaqja e mbjelljes 0.5 ha;
- Densiteti i mbjelljes 2x2m;
- Formula e mbjelljes 0.5 Pisha e eger (P.halepensis) + 0.5 Pishë (P.pinea).
- Numri i filizave: Pishë e eger (P.halepensis) 625; Pishë (P.pinea) 625;
- Numri i filizave Total: 1250.

Parcela nr.15c Vain, ndodhet në pjesën përfundimtare të bregdetit të Vainit.

- Emri lokal: “Rera e detit“ ;
- Sipërfaqja e mbjelljes 3 ha;
- Densiteti i mbjelljes 2x1.25m Marinë (Tamarix parviflora D.C.) dhe specie të tjera 2x 2.5m.
- Formula e mbjelljes 0.19 Pishë P.pinea) + 0.19 Pishë e eger (P.halepensis) + 0.46 Marinë (Tamarix parviflora D.C.) + 0.08 Lis (Q.pendunculata) + 0.08 Frasher (F. ornus).
- Numri i filizave: 1300 Pishë e eger (P.halepensis), 1300 Pishë (P.pinea); 3120 Marine (Tamarix parviflora D.C.), 520 Lis (Q.pendunculata), 520 Frasher (F. ornus).
- Numri i filizave Total: 6760.

Parcela nr.27a, ndodhet në anën jugore të grykëderdhjes së lumit Drin, në një distancë 2.47 km larg prej saj. Kjo zonë është përdorë në të kaluarën për rritjen e fazanave.

- Emri lokal: “Ish Fazaneria“;
- Sipërfaqja e mbjelljes 0.4 ha;
- Densiteti i mbjelljes 2x2m;
- Formula e mbjelljes 0.6 Lis (Q. pendunculata) + 0.4 Pishë e eger (P. halepensis);
- Numri i filizave: Lis (Q.pendunculata) 600; Pishë e eger (P. halepensis) 400;
- Numri i filizave Total: 1000.

Ripyllzimi përgjatë rrugëve

Parceala nr.	Sipërfaqja	ml	Rruga, emri lokal	Frasher	Leander	Marine	Numri Total
	0.27	2700	Argjinatura Hidrovor Shengjin	900	1800	0	2700
	0.18	1800	Argjinatura Vorbes - Hidrovor	600	0	1200	1800
	0.05	400	Rruga auto Zyrat e RAPA. Lumi Drin	0	200	300	500
Total	0.5	5000		1500	2000	1500	5000

Figura 1 Te dhëna për ripyllzimet përgjatë rrugëve.



Figura 2 Vend-ndodhja e ripyllzimeve (SLKV)

2.3 Ripyllëzimi si qasje EbA

"Përshtatja është një rregullim në sistemet natyrore ose njerëzore si përgjigje ndaj ndryshimit aktual apo të pritshëm të bregdetit dhe stimujve klimatikë ose efekteve të tyre, që moderon dëmin ose shfrytëzon mundësitë e dobishme. Në kushtet e ripyllëzimit, përfitimi kryesor i përshtatjes është sigurimi i qëndrueshmërisë së ekosistemit tokësor brenda zonave bregdetare, duke siguruar kështu buffer (amortizim) natyralë "rripi të gjelbër" nga stuhitë përmblytëse, ndërkohë që rriten shërbimet e ekosistemit për një serë palësh të interesuara ".(Ecosystem Based Adaptation Protocols Report Jonathan McCue 2017).

Zona e Kune Vainit është identifikuar si një zonë shumë e ekspozuar ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Stuhitë e detit, veçanërisht në dekadën e fundit, janë bërë mjaft të shpeshta dhe të fuqishme, duke shkaktuar mbi të gjitha një erozion agresiv në zonën bregdetare të Kune Vain. Në këtë kontekst, zbatimi i masave përshtatëse siç është ripyllëzimi merr një rëndësi të veçantë si zë EbA.

2.4 Protokoll i mirëmbajtjes për ripyllzimet në Kune Vain.

Në protokollet EbA, theksohet se për sa i përket ri-ripyllëzimit, përfitimi kryesor i përshtatjes është të mundësojë qëndrueshmërinë e ekosistemeve tokësore brenda zonave bregdetare, duke siguruar kështu "rripa jeshilë" që mbrojnë nga stuhitë, duke rritur shërbimet e ekosistemit për grupet e interesit.

Protokollet e EbA-s japin specifikime të hollësishme për aktivitetet e ripyllëzimit në Kune Vain, siç janë karakteristikat e zonave të propozuara dhe përshkrimin fizik të tyre, kriteret kryesore të vendit për zgjedhjen e zonave, zgjedhjen e specieve rezistente ndaj klimës, dendësia e mbjelljes dhe metodat e preferuaratë mbjelljes.

Përveç kësaj, në protokollet EbA, shërbimet e mirëmbajtjes janë gjithashtu të specifikuar, të cilat kryesisht varen nga zëvendësimi i fidanëve të tharë dhe marrja e masave të tjera mbrojtëse.

2.5 Ripyllzimi - mirëmbajtja.

Punimet e mirëmbajtjes janë parashikuar në projektin e ripyllëzimit, të hartuar nga NCETSD & Diava Consulting), si vijon.

Nr	Përshkrimi i punimeve të mirëmbajtjes	Shërbimet e planifikuara për objektin	
		Viti i parë	Viti i dytë
1	Prashitja e fidanëve të mbjellë me një rreze 0.5m.	2 herë	2 herë
2	Plehërimi pas mbirjes së fidanëve, 100 gr/bimë		
3	Ujitja e fidanëve në ripyllëzimet me 30 litra ujë në një distancë prej 100 metrash,	2 herë	2 herë

Tabela1. Punimet e mirëmbajtjes së planifikuara për ripyllzimet

Nr.	Parcela Nr.	Sipërfaqja ha	Shpenzimet në \$US/parcelë
1	13.b Ana veriore bregdetare e Kunes	3.1	10540
2	21.a Stomi i Nikoll Luces	0.5	1700
3	15.c Rera e detit	3	7233
4	27.a. Ish Fazaneria	0.4	1188
5	Përgjatë rrugëve, brenda SLKV, 5 km		5788
Total			26449

Tabela2. Përmbledhje e shpenzimeve për punimet e mirëmbajtjes (për dy vjet të kultivimit).

Vegjetacioni i ri i formuar ka nevojë për shërbime të mirëmbajtjes dhe kujdes të vazhdueshëm. Punët e mbjelljes dhe ato të mirëmbajtjes duhet të kryhen në përputhje me rregullat dhe kushtet e zonës natyrore të mbrojtur, si vijon:

- Kufizimi i lëvizjeve të automjeteve dhe mjeteve të tjera sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrë që të shmangët dëmtimi i ndonjë bimë tjetër të instaluar në mënyrë natyrale.
- Shmangia e zhurmës gjatë zbatimit të punimeve veçanërisht kur ato kryhen në periudhën Maj-Korrik, kur ndodh shumimi i shpëndëve.
- Përdorimi i plehrave kimikë në mënyrë të kontrolluar në lidhje me standartin e produktit dhe kujdesin në lidhje me sasinë për fidanë.
- Mbetjet e krijuara nga punët e mirëmbajtjes si qese plastike, duhet të menaxhohen në përputhje me rregulloren për zonat e mbrojtura.
- Kur punimet do të kryhen nga subjektet e kontraktuara, ata duhet të njoftojnë përpara përfaqësuesit e AdZM, të cilët duhet të bëjnë mbikëqyrjen e veprimtarisë.

2.4 Mirëmbajtja afatgjatë e ripyllzimeve

Pas punës intensive të mirëmbajtjes të dy viteve të para, shërbimet në zonat e mbjella nuk duhet të ndërpriten dhe duhet të përqëndrohen në veçanti në një seri masash që merren me ruajtjen dhe kujdesin e tyre nga dëmet e tjera që mund të pësojnë.

Shërbimet e mirëmbajtjes duhet të bëhen të paktën derisa bimësia të adaptohet plotësisht me mjedisin natyror, dhe konkurrues me llojet e tjera të bimësisë, për aq sa përqindja më e madhe e fidanëve të mbjellë, do të sigurojë mbijetesë dhe zhvillim normal. Këta tregues do të merren nga rezultatet e aktiviteteve kërkimore dhe monitoruese.

Pas përfundimit të projektit, rekomandojmë që shërbimet e mirëmbajtjes, të përqëndrohen dhe zhvillohen sipas këtij plani mirëmbajtjeje afatgjatë si vijon.

Nr	Aktivitetet e mirëmbajtjes	Frekuenca	Periodiciteti	Periudha kohore	Pergjegjesit	Burimet e buxhetit
1	Zevendesimi i fidaneve të tharë.	Nje herë në vit	2019-2020	Vjeshtë 2019-2020	Subjekti i kontraktuar	Projekti EbA
2	Kontroll për ruajtjen e bimësisë së mbjellë, nga kullotja.	Çdo ditë	2019- e vijim		AdZM	AdZM
3	Zbatimi i masave mbrojtëse nga dëmtuesit	Çdo vit	2019- e vijim	Sipas rezultateve të monitorimit	AdZM	AKZM
4	Kontrolli dhe riparimi i garthimeve rrethuese derisa bimësia të mos dëmtohet nga kullotja.	Çdo javë	2019- e vijim		AdZM	Projekti EbA AKZM
5	Ujitja në rast të thatësirës së zgjatur.	Sipas ngjarjeve ekstreme	2019- e vijim	Sipas ngjarjeve ekstreme	AdZM Subjekti i kontraktuar	AKZM
6	Mirëmbajtja dhe riparimi i tabelave që tregojnë zonën e mbjelljes	Çdo muaj	2019- e vijim	Sipas rasteve	AdZM	AKZM
7	Ndërgjegjësimi i vizitorëve, frekuentuesve të plazhit dhe komunitetit në tërësi për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e bimësisë së mbjellë.	Në veçanti në periudhën verore	2019- e vijim		AdZM	AKZMKM ZML

Tabela3. Aktivitetet e mirëmbajtjes, plani strategjik.

Shënim: Nga vëzhgimet e bëra deri tani, dëshmohet tharja e disa fidanëve të mbjella (Pisha eger ose P.halepensis, dhe Pisha, ose P.pinea) në ngastrën 21.a "Stomi i Nikoll Lucës". Si shkak kryesor për këto tharje, vlerësohet të jetë prezenca e shtuar e ujit me kripë në këtë parcelë. Edhe pse kompania ALbGarden ka kryer punime kullimi, siç theksohet, ndikimi nga prania e ujit të kripur në bimësinë e mbjellë nuk është eliminuar.

Për këtë arsye, rekomandohet që zëvendësimi i fidanëve të pishave të thara, të bëhet me Marine (Tamarix parviflora D.C.), e cila është më rezistente ndaj ndikimit të ujit me kripë, që është më i pranishëm në këtë parcelë. Sidoqoftë, ky rast do të dëshmohet më së miri nga zbatimi i programit të kërkimit dhe monitorimit.

3. Rehabilitimi i Dunave

3.1 Protokollet teknike per rehabilitimin e dunave - rekomandimet dhe përfitimet kryesore

*Në PTRD, theksohet se "Zona më e përshtatshme e mbjelljes për projektet e rehabilitimit të dunës duhet të jetë vendndodhja mbi kufirin normal të rrahjes nga vala e detit, në çdo vend ku era sjell rere në dispozicion. Bimesia inkurajon rritjen e dunave nga kapja dhe stabilimi i reres që sjell era. Mbjellja e bimësisë do të zvogëlojë gjithashtu shpejtësinë e erës mbi sistemin e dunës duke inkurajuar depozitimin e rërës. Bari i plazhit (*Ammophila arenaria* L.) është veçanërisht i efektshëm në arritjen e kësaj sepse ka një tolerancë të lartë ndaj rrezatimit diellor të përmirësuar dhe duke qenë një specie vendase, ai është shumë i përshtatur me kushtet mjedisore që gjenden përgjatë vijës bregdetare shqiptare. Prandaj rekomandohet mbjellja e barit të plazhit, (*Ammophila arenaria*) për projekte të restaurimit të dunave në Shqipëri, pasi kjo përfaqëson një nga bimët e pakta që është në gjendje të mbijetojë në kushte ekstreme që hasen shpesh.*

Përfitimi kryesor i përshtatjes nga rehabilitimi i dunës është të përmirësojë rezistencën e habitateve natyrore të dunave ndaj kërcënimit të rritjes së niveleve të detit, stuhive dhe kushteve klimatike që mund të ndikojnë në aftësinë natyrore të sistemit për t'iu përgjigjur kërcënimeve të klimës. Bashkë-përfitimet e veçanta të qasjes përfshijnë rivendosjen e biodiversitetit natyror të bimëve dhe kafshëve të dunës dhe duke ndihmuar restaurimin, sipas rastit, të disa proceseve natyrore që mbështesin ekosistemet e dunave. Çelësi për ruajtjen e diversitetit të ekosistemeve të dunës është heqja e bimëve jo-vendase, (pushtuese) nga dunat bregdetare. Kur bimët pushtuese janë hequr, ato vendase kthehen, duke krijuar kushte për të depozituar në mënyrë periodike rërën nga forcat natyrore si era dhe deti. Ky sistem gjysmë i qëndrueshëm krijon kushte për shumëllojshmëri të bimëve dhe kafshëve, përfshirë insektet (bletët vendase) dhe shumë specie shpëndësh që folezojnë atje". (*Ecosystem Based Adaptation Protocols Report Jonathan McCue 2017*).

3.2 Përse është e nevojshme ndërhyrja:

Erozioni bregdetar ka shkatërruar një pjesë të konsiderueshme të dunave bregdetare dhe bimësisë pyjore duke zvogëluar vlerat natyrore të zonës së mbrojtur KVT. Siç përshkruhet në Planin e Menaxhimit të lagunës së Kune-Vain të hartuar në vitin 2010 (f. 89), erozioni i detit është një nga problemet kryesore dhe duhet të ndërmerret veprime për zvogëlimin dhe eliminimin e këtij fenomeni. Ajo klasifikohet si shumë e rëndësishme në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar. Si shkaqe kryesore të ndryshimeve në vijën bregdetare në këtë zonë sipas studimeve të kryera deri më tani, janë aktiviteti njerëzor dhe ndryshimet klimatike.

Si rezultat i këtyre faktorëve është dëmtuar ekosistemi i dunave në të gjithë vijën bregdetare të zonës së mbrojtur Kune-Vain (me përjashtim të një pjese të vogël në veri të bregdetit të ishullit të Kune). Dëmtimi i këtij habitati të rëndësishëm është ndikuar nga:

- Rritja e vulnerabilitetit të zonës bregdetare ndaj erozionit dhe stuhive detare si rezultat i ndryshimit të klimës.

- Renia e biodiversitetit. Vendet e shumimit të shpëndëve të tillë si dallëndyshja e detit (Common Tern, *Sterna hirundo*), janë dëmtuar.
- Pushtimi i dunës nga bimë jo-vendase dhe invazive duke shkatërruar ekuilibrin ekologjik të ekosistemeve natyrore.
- Vendosja e një çekuilibrimi midis erozionit dhe rehabilitimit të procesit natyror.

Bazuar në rëndësinë dhe pasojat e këtij fenomeni siç është parashikuar në Planin e Menaxhimit të Kune Vain Tale (PMKVT), objektivi kryesor operacional mbetet mbajtja nën kontroll e dinamikës gjysmë natyrore të bregdetit (kontrolli i erozionit) përmes masave përshtatëse në ekosistem.

Objektivi/qellimi i ndërhyrjes, është të ristrukturojë dunat e degraduara në vijën bregdetare të Kune për të rritur rezistencën e habitatit bregdetar ndaj ndryshimeve të pritshme të klimës dhe të përmirësojë shëndetin bregdetar, në mënyrë që të restaurohen përmes zbatimit të masave biologjike (mbjellja me specie bari vendase)të dunave të rrezikuara.



Figura 4. Vend-ndodhja e rehabilitimit te dunave (SLKV)

3.3 Pershkrimi i shkurtër i ndërhyrjes.

3.3.1 Speciet e zgjedhura për mbjellje

Bari i plazheve (*Ammophila arenaria* L).

Bari i plazheve (*Ammophila arenaria*L.) është bime kserofite (rritet në mjedise me pak lageshtire) që mund të perballojë kushtet e reres e të thatesires ku shumica e bimeve nuk mund të mbijetojnë.

Ka një tolerancë të moderuar ndaj tokave të mjediseve të kripura (rreth 15 g/l, ose 1.5%). Ajo është një bime shumëvjeçare dhe rritet deri në 1.2 metra në lartësi. Rritet prej një rrjeti i rizomash të trasha që i japin bimes një mbeshtetje të fuqishme në rërë dhe që mundesojnë që ajo të rritet jashtë. Këto rizoma mund të rriten (shtrihen) anash deri në 2 metra. Një grumbull bimesh (kacube) mund të prodhojë deri 100 fidane çdo vit. Rizomat tolerojnë permytjen e ujit të detit dhe mund të levizin përmes rrymave duke u vendosur në zona të tjera (duke mbire). Gjethet janë të trasha dhe të veshura në një shtresë të bardhë prej dylli. Ato janë të gjata deri në 1 metër. Stomat (gojezat) ndodhen në sipërfaqen e brendshme të gjethëve të lakuara, duke minimizuar maksimalisht humbjen e ujit. Ndërsa ana e jashtme e gjethës ka një strukturë të fortë qelizore e afte për të rezistuar erës dhe gervishtjeve (abrazionin) nga rera. Në periudhën me lageshti, qelizat e brendshme (si pjesë të sistemit hidraulik) fryhen si ballon duke bërë shpeshjtjelljen e gjethëve. Lulesa ka formë cilindrike dhe është deri në 30 centimetra e gjatë.

Ammophila arenaria, është specie me aftësi të mira për “kapjen (në kurth)” të reres që zhvendoset nga era dhe ndikon në ndërtimin e sistemit të dunave të bregdetit që konsiderohen habitate mjaft të rëndësishme për biodiversitetin (për kafshët e egra). Kjo bime është përshtatur mjedisit të thatë ranor, e cila në periudhat e gjata të thatesires, mbeshtjell gjethet për të zvogeluar humbjen e lageshtires prej bimes.

Marina (*Tamarixparviflora* DC.)

Është bimë në trajtë shkurreje dhe mund të arrijë deri në 5 m lartësi. Shumëzohet lehtë me kalema. Është lloj i klimës mesdhetare. Kërkon toka të lehta me përmbajtje të konsiderueshme rëre dhe me ujra freatikë në afërsi të sipërfaqes. Në vendin tonë takohet dendur në shtretërit e lumenjve dhe buzë kënetave apo detit.

3.3.2 Vend-ndodhja dhe skema e mbjelljes

(Projekti i rehabilitimit të Dunave është hartuar nga NCETSD & Diava Consulting dhe të dhënat janë marrë nga ky projekt).

Vendi ku aplikohet projekti ndodhet në ishullin Kune, në pjesën bregdetare të detit Adriatik. Objekti i përket ekonomisë pyjore Shëngjin-Tale, në parcelën 13b. Sipërfaqja që do të rehabilitohet, është 18000 m².

Sipërfaqja totale për mbjellje në (m ²)	Sipërfaqja e ndarë në parcela (m ²)	% e çdo parcele	Skema e mbjelljes për çdo specie		Numri i fidaneve për çdo parcelë		Bimë per njësi (m ²)
			Marina	Ammophila arenaria	Marina	Ammophila arenaria	
18000	1146	6	1x1	1x1 m	3426	3426	3.0
	4011	22		70*50 cm	0	11460	2.85
	6876	38		60*50 cm	0	22920	3.3
	6016	34		50*50 cm	0	24066	4.0
TOTAL i filizave					3426	61872	

Tabela5. Rehabilitimi i dunave, skema e mbjelljes

3.3.3. Shërbimet pas mbjelljes

Disa nga masat që duhet të ndërmerren janë:

- a. Krasitja e bimëve të cilat kanë një rritje më të madhe sesa normalja
- b. 2-3 ujitje të fidanëve të mbjellë në periudhën Qershor-Gusht në varësi të regjimit termik. Periudha ndërmjet dy ujitjeve varet nga temperaturat e stines, por rekomandohet që ujitja të bëhet kur vërehen reagimet e bimes ndaj thatesirës (tharje të pjeseve të ndryshme të sajës). Për çdo bime rekomandohet të perdoren 0.5-1 liter ujë. Uji që do të perdoret për ujitje të jete i embel dhe të merret nga zona perreth. Për të patur bime të shëndetshme rekomandohet që në ujë të tretet edhe pleh organik. Rekomandohet që raporti pleh organik-ujë të jete 1:10, pra për çdo 10 litra ujë të tretet 1 kg pleh organik.
- c. Pastrimi i sipërfaqes nga bimët invazive në sezonin e parë të mbjelljes.

Sipas projektit, në fund të sezonit të parë (në vjeshtën pasardhëse) do të aplikohet zëvendësimi i të gjitha bimëve që nuk mbijetuan në vitin e parë të mbjelljes. Procesi i zëvendësimit do të jetë i njëjtë me atë për mbjelljen normale.

Aktiviteti	Vlera \$/ha	Sipërfaqja (Ha)	Vlera Totale \$ (USD)	Ditë pune
Punimet e mbjelljes	61473	1.8	110650.6	1 017
Punimet e mirëmbajtjes	8100	1.8	14580	5 48
TOTALI	69573		125230.6	1 565

Tabela6. Kostot totale të rehabilitimit të dunave.

Në fund të sezonit të parë pas mbjelljes, në shtator do të monitorohet sasia dhe përqindjen e fidanëve të zëna. Në këtë fazë përcaktohet gjithashtu edhe sasia e fidanëve që do të rimbillen.

3.3 Mirëmbajtja afatgjatë për rehabilitimin e dunave.

Të gjitha masat e identifikuar për mirëmbajtjen e dunave janë shumë të ngjashme me ato për mirëmbajtjen e vendeve të mbjella për restaurimin e pyjeve, por ndryshimet lidhen me atë që vendi ku do të bëhet rehabilitimi i dunave është i përballur drejtpërdrejt me stuhi detare dhe erëra të forta.

Gjithashtu, rreziqet e dëmtimeve nga faktorë të tjerë si i shkeljes me këmbë nga njerëzit veçanërisht gjatëperiudhës së plazhit, dhe nga ndotja e zonës si rezultat i keqmenaxhimit të mbeturinave, mund të ndikojnë në suksesin e ndërhyrjes.

Identifikimi i masave të mirëmbajtjes afatgjatë të mbjelljeve për rehabilitimin e dunës, bazohet në veçanti në kushtet specifike të zonës, sa është i arritshëm nga njerëzit, a ka ndonjë prani të bagëtive në afërsi, etj.

Nr	Aktivitet e mirëmbajtjes	Frekuenca	Periodiciteti	Periudha kohore	Pergjegjesit	Burimet e buxhetit
1	Zevëndesimi i fidaneve të tharë	Nje herë në vit	2019-2020	Vjeshtë 2019-2020	Subjekti i kontraktuar	Projekti EbA
	Kontroll i menjëhershëm pas ngjarjeve ekstreme klimatike, si stuhitë detare të shoqëruara me erëra të forta, identifikimin e dëmeve dhe marrjen e masave të nevojshme	Pas ngjarjeve ekstreme klimatike	2019- e vijim		ADZM (KTL)	ADZM
2	Kontroll për ruajtjen e bimësisë së mbjellë, nga kullotja	Në çdo kontroll rutinë të rëngjersave	2019- e vijim	Në çdo kontroll rutinë të rëngjersave	ADZM (KTL)	ADZM
4	Kontrolli dhe riparimi i garthimeve rrethuese derisa bimësia të mos dëmtohet nga kullotja..	Çdo javë	2019- e vijim		ADZM (KTL)	Projekti EbA AKZM
5	Ujitja në rast të thatësisë së zgjatur	Sipas ngjarjeve ekstreme klimatike	2019- e vijim	Sipas ngjarjeve ekstreme klimatike	ADZM Subjekti i kontraktuar	AKZM
6	Mirëmbajtja dhe riparimit i tabelave që tregojnë zonën e mbjelljes	Çdo muaj	2019- e vijim	Sipas rasteve	ADZM	AKZM
7	Ndërgjegjësimi i vizitorëve, frekuentuesve të plazhit dhe komunitetit në tërësi për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e bimësisë së mbjellë.	Veçanërisht në periudhën e verës	2019- e vijim		ADZM KMZML (KTL)	AKZM

Tabela4. Aktivitetet e mirëmbajtjes, plani strategjik.

4. Hapja e Kanalit të Baticës (kanali i ujëkëmbimit midis detit Adriatik dhe lagunës së Cekës, Vain).

4.1 Pse është e nevojshme ndërhyrja

Siç dihet, qëllimi kryesor i kanalit të komunikimit është futja dhe shpërndarja e ujërave në lagunë gjatë baticës detare, dhe lëshimi i ujrave nga laguna në det gjatë zbatës. Në këtë kanal uji do të lëvizë përgjatë dy drejtimeve dhe për këtë arsye kanali projektohet pa pjerrësi, d.m.th në nivel horizontal. Në këtë mënyrë, lëvizja e ujit do të ndodhë si rezultat i drejtpërdrejtë i nivelit të rritur të ujit nga një pellg në tjetrin (pellgu i detit dhe ai i lagunës).

Për shumë vite, Laguna e Cekës vuan nga qarkullimi dhe shkëmbimi i kufizuar i ujit me detin. Kjo lagunë është e lidhur me detin përmes një kanal 3,000 metra të gjatë (Kanali i Matkeqes) në veri të plazhit të Tales. Pozicioni i grykës së kanalit migron në varësi të kushteve mbizotëruese të valës. Dy prerje artificiale (kanale ujëkëmbimi) janë bërë përmes plazhit në të kaluarën, kryesisht nga iniciativat e peshkatarëve, për të përmirësuar shkëmbimin e ujit, por ato natyrisht janë mbushur me sedimente të transportuara, gjatë një kohe të shkurtër. Stacioni i Pompimit Tale, (hidrovori), i ndërtuar në vitin 1962, i vendosur në jug të Lagunës së Cekës pompon rrjedhje ujore të patrajtuar (që përmbajnë ndotës) në kanalin e komunikimit lagunë - detë dhe që përfundimisht arrin në lagunë. Për shkak të lidhjes së dobët përmes grykës së këtij kanali (bllokimi here pas here nga sedimentet detare), një pjesë e ujrave mbledhes tëreshjeve në rrjetin hidrik (të ndotur) nga hidrovori hyn në lagunë. Ujërat e derguara nga hidrovori, zvogëlojnë kripësinë në ujrata e lagunës dhe e ndotin atë, dukë e vënë lagunën në rrezik të lartë të eutrofikimit.

4.2 objektivi dhe zgjedhja e vendit të ndërhyrjes:

Qëllimi kryesor është të ndërtohet një kanal komunikimi, i cili do të bëjë të mundur qarkullimin e lirë të ujërave të detit Adriatik me lagunën e Cekës, gjatë procesit të baticës e zbatës dhe si rezultat, përmirësimin e situatës ekologjike të lagunës së Cekës. Sipas projektit, (hartuar nga STAR ENGINEERING JV NORD-COMAT), vendi për hapjen e kanalit u zgjedh të jetë në gjurmët e një të vjetëri, për 3 arsye kryesore, si më poshtë:

- Paraqet distancën më të shkurtër të mundshme;
- Përdor kanalin ekzistues, d.m.th. më pak punime ndërtimore;
- Bën ndikimin minimal në mjedis (bimësia drunore përreth, flora dhe fauna).

Kjo ndërhyrje siç përcaktohet në projektin e hartuar, gëzon mbështetjen e plotë të komunitetit të peshkatarëve lokalë si palë e interesuar, jetesa e të cilëve është e lidhur ngushtë me ekzistencën e vetë lagunës. Gjithashtu, vendi për hapjen e kanalit u zgjedh pasi u plotësuan kërkesat teknike, ekonomike, mjedisore dhe sociale.



Figura 4. Vend-ndodhja e ndertimit te kanalit te batices (SLKV)

4.3 Të dhëna teknike

Pjesa e brendshme e kanalit ka një formë trapezoidale, ndërsa në vazhdimi e tij me detin nuk ka faqe anësore dhe perfundon deri në pikën ku arrin një thellësi të përshtatshme të detit.

Të dhënat themelore të seksionit të kanalit në mënyrë të përmbledhur, janë si më poshtë:

b - Baza e vogel e seksionit trapezoidal $b = 13$ m

b - Baza e madhe, $b = 33$ m (niveli i lartëeshtë +1.50m mbi nivelin e detit)

m - Pjerresia e aneve 2.5 m (p.sh.. 1-vertikal dhe 2.5-horizontal)

h - Thellessia e kanalit, = 4.00m, (niveli fundor i kanalit i barabartë me -2.50m, duke rezultuar pra në një thellësi që është $h = 2.20$ m)




Figura 5. Seksioni i kanalit (projekti i hartuar nga STAR ENGINEERING JV NORD-COMAT)



TECHNICAL NOTES

- BOTH DIMENSIONS AND LEVELS ARE SHOWN IN [meters]
- FOR THE INLAND PART, THE BOTTOM AND TOP LEVELS OF THE TIDAL CHANNEL ARE CONSTANT (no-geophysical slope)
- ALSO FOR THE SEA PART, THE BOTTOM LEVEL OF THE TIDAL CHANNEL IS CONSTANT (no-geophysical slope)
- THERE ARE NO LATERAL SLOPES FOR THE SEA PART.
- THE WORKS WILL PROCEED UNTIL THE SEA LEVEL OF -2.50m IS REACHED.
- THE SURFACE OF SOIL THAT IS EXPOSED DURING THE CONSTRUCTION WORK SHOULD NOT BE COVERED BY THE SURFACE OF THE JOB.
- BEFORE THE BEGINNING OF THE CONSTRUCTION PHASE, A TOPOGRAPHIC/SURFIMETRIC SURVEY SHOULD BE PERFORMED. IF SIGNIFICANT CHANGES OF SEA LEVELS ARE ENCOUNTERED THEN THE DESIGNER SHOULD BE NOTIFIED.

PROJECT: TIDAL INLET CHANNEL, KUNE-VAINI LAGOON SYSTEM		LOCATION: LEZHE, ALBANIA	
CLIENT: MINISTRY OF ENVIRONMENT OF ALBANIA		DATE: APRIL 2017	
TITLE: IMAGE VIEW OF THE TIDAL CHANNEL		SHEET NUMBER: 01	
DESIGNER: NORD-COMAT SHPK	Lic: N.6716/2		FORMAT: ISO A-1
DESIGNER: ING. OSSAMA LABIB EKLADIOUS	Lic: K.1235/2		SCALE: 1:100
DESIGNER: STAR ENGINEERING SHPK	Lic: N.6541/4		REVISION:
DESIGNER: ING. AUREL HASHO	Lic: Z.4786		
DESIGNER: ING. FLORENC DABERDAKU	Lic: K.1138/3		
DESIGNER: ING. SEAD SADIKU			

Figura 6. Pamje e kanalit nga imazhi satelitor dhe projekti i hartuar nga STAR ENGINEERING JV NORD-COMAT.

4.4 Kanali ibaticës si qasje EbA

"Një ndikim kryesor i ligatinave dhe hyrjeve të baticës (brenda grykëderdhjeve) dhe vlefshmëria e tyre si një masë e efektshme EbA në zona, është kontributi që japin për përcaktimin e prizmit të baticës (d.m.th: vëllimi i ujit që futet në një hyrje gjatë valës së baticës ose daljes gjatë zbaticës).

Ndërsa ligatinat humbasin ose restaurohen (përmes krijimit ose ndryshimit të kanalit të hyrjes së baticës), nga modifikimi i prizmit të baticës. Ndryshimet në prizmin e baticës kanë disa implikime në hidrodinamikën e grykëderdhjeve dhe rrjedhimisht, transportin e sedimenteve dhe morfologjinë ". (Ecosystem Based Adaptation Protocols Report Jonathan McCue 2017).

Në rastin tonë, mungesa e ndërtimit të barrierave mbrojtëse (barriera fundore, në të dy anët e kanalit në pjesën e bregut deri në thellësinë e caktuar në detë) si pjesë e hyrjes të kanalit të baticës, thjesht për shkak të kostove të larta që ata paraqesin, ka favorizuar mbushjen e shpejtë me sedimente të këtij kanali deri në bllokimin e tij. Në këto kushte, mbajtja e hapur e kanalit duke u thelluar, mbetet përparësi. Sa më lart, zbatimi i masave të mirëmbajtjes, ka një rëndësi të veçantë. Zona bregdetare e Kune Vainit, po përballlet nga stuhi të fuqishme detare, për rrjedhojë, erozioni bregdetar po bëhet gjithnjë e më agresiv. Vetëm brenda viteve 2018-2019, kjo situatë përsëritur 3 herë.

4.5 Protokoli i mirëmbajtjes për kanalën e baticës

Ulja e kapacitetit të ujëkëmbimit përmes kanalit të komunikimit midis Detit Adriatik dhe Sistemit lagunor Kune Vain, është një problem i njohur prej vitesh. Kështu, është e mundur që uji në laguna të bëhet gjithnjë e më eutrofik për shkak të këtij shkëmbimi të kufizuar. Sipas protokollit EbA, konsiderohen katër masa të adaptimit:

- Metodave strukturore për të kufizuar akumulimin e sedimenteve në kanale;
- Pastrimi i rregullt e kanaleve për mirëmbajtjen e funksionimit;
- Rritja e prizmës të baticës dhe rrjedhës së tanishme (dhe rrjedhimisht pastrimit) nëpër kanalet e baticës përmes rindërtimit të menaxhuar të zonave të tokave bujqësore; dhe
- Shkarkimi i kontrolluar i ujit të ndotur nga stacionet e pompimit.

4.6 Mirëmbajtja afatgjatë e kanalit të baticës, sistemi lagunor Kune Vain.

4.6.1. Qëllimi dhe objektivat:

Identifikimi dhe zbatimi i masave afatgjata të mirëmbajtjes për përmirësimin optimal të shkëmbimit të ujit midis detit Adriatik dhe lagunës së Cekes për të siguruar kushte të mira ekologjike në lagunën e Cekes, dhe shërbimeve të përfitimeve sociale ekonomike për komunitetin.

4.6.2 Justifikimi/ Përshkrimi

Në raportin teknik të Kanalit të Baticës, sistemi i lagunor Kune-Vain, hartuar nga STAR ENGINEERING JV NORD-COMAT, është përpiluar programi i mirëmbajtjes që do të zbatohet pas hapjes ose ndërtimit të kanalit. Në këtë program sqarohet se në mungesë të barrierave të mbrojtëse, duhet të mbështeteni në një program periodik të mirëmbajtjes së kanalit të baticës, në mënyrë që të hiqen depozitimet e rërës nga shtrati i kanalit. Kjo për arsye se depozitimet e rërës janë të pashmangshme, për shkak të humbjes së ekuilibrit të shkaktuar nga ndërtimi i vetë kanalit. Vlerësohet se sasia vjetore e rërës që lëviz brenda kanalit është e barabartë me 20-25% të sasisë së rërës që është gërmuar (sipas projektit) për të hapur kanal, dmth ~.3000 m³. Gjysma e kësaj sasive duhet të zhvendoset për pastrimin e kanalit, një herë në 6 muaj.

Prandaj mirëmbajtja është thelbësore për të patur një kanal të baticës plotësisht operativ. Është gjithashtu thelbësore që vëzhguesit e kanalit të baticës të bëjnë një matje të azhurnuar në mënyrë periodike (topografike / batimetrike). Nëse ka një tendencë për të tejkaluar sasinë e parashikuar më lart, periodiciteti i zhvendosjes së sedimenteve nga kanali duhet të jetë më i shpeshtë, d.m.th një herë në 4 muaj.

4.6.3 Masat e mirëmbajtjes për t'u zbatuar

- Mirëmbajtja dhe thellimi i kanalit të ri (Pastrimi/ thellimi i kanalit të ri të baticës nga sedimentet e depozituara).

Frekuenca: Mirëmbajtja dhe thellimidi here në vit i kanalit të ri të baticës për të parandaluar mbylljen (sipas matjeve topografike/batimetrikeperiodike). Afërsisht 1500 m³ rërë, duhet të zhvendoset, një herë në 6 muaj. Nëse sasia e sedimenteve është më shumë se 3000 m³/ vit, periodiciteti duhet të jetë më i shpeshtë, d.m.th një herë në 4 muaj).

Buxheti: Punimet e mirëmbajtjes duhet të llogariten në bazë të shpenzimeve të përcaktuara për vitet 2019-2020. Këto shpenzime duhet të planifikohen për të gjitha vitet pasuese.

Bazuar në planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur të Kune Vain Tale, për mirëmbajtjen vjetore të kanaleve, afërsisht jo më shumë se 30,000 USD, janë të mjaftueshme për mirëmbajtjen e kanalit të ri të baticës midis Lagunës së Cekes dhe Detit Adriatik.

Periodiciteti: Çdo vit.

Periudha kohore: 2019 dhe në vijim.

Përgjegjësitë: AKZM, ADZM Lezhë, Kompania e peshkimit "LURA".

Propozime në lidhje me funksionimin e Kanalit të ritë baticës:

- Vendosja e barrierave (barriera ose prita fundore) në gryken e kanalit, (aty ku kanali komunikon drejtpërdrejt me detin).
- Ndërtimi i barrierave me materiale natyrore si blloqe të rënda shkëmbore, mund të sigurojë një stabilitet afatgjatë të funksionimit të kanalit. Për situata të shpejta urgjente, mund të aplikohet, vendosja e thaseve të mbushura me rërë, por natyrisht janë më pak të qëndrueshme.
- Ndërtimi i portës lëvizëse në pikën ku kanali i ri i baticës devijohet nga kanali i vjetër që vjen nga stacioni hidrovorit. Kjo portë parandalon hyrjen e ujit që vjen nga stacioni i pompimit në lagunë, do të

hapet vetëm në raste urgjente. Këtu, kemi parasysh, raste të bllokimit të kanalit të ri të baticës dhe pamundësisë për të shpejtuar mirëmbajtjen e tij.

4.7 Plani për vazhdimin e mirëmbajtjes pasi projekti ka përfunduar.

Menaxhimi i ndërhyrjeve të bëra dhe i shërbimeve të mirëmbajtjes së tyre nga ADZM, veçanërisht në dy vitet e para do të jetë shumë intensive.

Përdorimi i një pjese të buxhetit të projektit për mirëmbajtjen e kanaleve nga ADZM do të rrisë përgjegjësinë e kësaj të fundit si administratore direkt e kësaj zone. Bashkëpunimi ADZM me Njësinë e Aktivitetit të Peshkimit (kompania LURA) është e domosdoshme.

Tashmë është provuar dhe praktikisht që mbajtja e kanalit të hapur nga projekti, sjell të gjitha përfitimet e parashikuara.

Bashkëpunimi i AKZM dhe ADZMLezhë me kompaninë e peshkimit LURA, duhet të adresohen në mirëmbajtjen e kanalit të ri, veçanërisht pas vitit të dytë dhe në të ardhmën, për të përfunduar sa më shpejt që të jetë e mundur ndikimet negative shumëvjeçare të hidrovorit të Tales, dhe përmirësimin e shkëmbimit të ujit të lagunës me detin. Është e rëndësishme të theksohet se ndërtimi i barrierave fundore me materiale natyrore të tilla si blloqe të rënda shkëmbore, mund të sigurojë një stabilitet afatgjatë të funksionimit të kanalit. Fillimi i punës së KMZML do të rrisë përgjegjësinë institucionale në menaxhimin e të gjitha ndërhyrjeve përmes mirëmbajtjes në SLKV, siç shprehet EbA.

5. Plani i komunikimit për të përhapur rezultatet e aktiviteteve të mirëmbajtjes

Rezultatet e monitorimit do të krijojnë një bazë të dhënash që do të konfirmojë nivelin e suksesit të ndërhyrjeve dhe mirëmbajtjen e tyre, dhe sa të qëndrueshme do të jenë përfitimet, si zëra EbA.

Rezultatet e mirëmbajtjes, si një ndërhyrje e thjeshtë teknike, do të jenë të lehta për tu identifikuar, ndërsa përfitimet në një spektër më të gjerë të EbA-s, siç janë ndikimet në përmirësimin e statusit ekologjik të zonës, përshtatjen dhe përballjen me efektet e ndryshimit të klimës dhe përfitimet social ekonomike, do të dëshmojnë nga një numër indikatorësh, nepermjet aktiviteteve kërkimore dhe monitoruese.

Rezultatet e mirëmbajtjes janë të lidhura ngushtë me rezultatet e kerkimit dhe monitorimit, të cilat do t'i komunikohen publikut të gjerë përmes raporteve teknike që do të prodhohen në baza dy-vjeçare. Si dhe në planin e komunikimit për shpërndarjen e rezultateve të kërkimit dhe monitorimit, rekomandohet që publiku i gjerë të informohet për aktivitetin e vazhdueshëm të mirëmbajtjes, një herë në vit përmes një portali online të AKZM dhe ADZM Lezhë si dhe Bashkisë Lezhë.

Për më tepër, do të përdoren, media të tjera sociale, të tilla si Facebook, për të informuar publikun për aktivitetet e mirëmbajtjes në lidhje EbA-n dhe masat adaptuese ndaj klimës, për të rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi vulnerabilitetin e klimës dhe përshtatjen. Rekomandohet gjithashtu publikimi i rezultateve në revista shkencore.